



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:130077

Datë: 23.03.2021

Numri i dokumentit: 01625654

C. nr. 231/19.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË –DEGA NË ISTOG, sipas gjyqtarit Migjen Kastrati, në çështjen juridiko - kontestimore të paditëses, Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës”, p.n, të cilën e përfaqëson e autorizuar L. Rr., sipas autorizimit, kundër të paditurit, K. S., nga fshatiKomuna e të cilin e përfaqëson Z. B., avokat nga Istogu, sipas autorizimit i angazhuar nga Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas, me bazën juridike, për rimbursimin e dëmit material, vlera e kontesti 764.00 Euro, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, në seancën publike të shqyrtimit kryesor, me dt. 18.03.2021, dhe përpiluar me dt. 23.03.2021 bie:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës”, p.n, **DETYROHET** i padituri: K. S., nga fshati, Komuna, që paditëses në emër të rimbursimin të dëmit material, për aksidentin e dt. 25.03.2017, ti paguaj shumën në lartësi prej 764.00 Euro, me kamatë ligjore 8 % duke filluar nga dita e ngritjes së kësaj padie me datën, 19.06.2019 e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e taksës për padi në shumë prej 20 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja nëpërmes të autorizuarës se saj ka paraqitur padi me dt. 19.06.2019, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesës se saj provave të bashkangjitura, duke deklaruar se kemi pranuar përgjigjën në padi, ku të njëjtën e kundërshtojmë pasi qe është në kundërthënie me provat, të bashkangjitura padisë, për faktin se lartësia e dëmit është vlerësuar në bazë të censorëve - ekspertëve të licencuar të BQK, e ku të njëjtit janë bazuar në raportin policor si dhe provave tjera, andaj një përgjigje e tillë është pa bazuar, mirëpo në si palë paditëse i ofrojmë edhe mundësinë e marrëveshjes në këste mujore duke hequr dorë nga kamat si dhe shpenzimet e procedurës - taksës për padi, me tutje ka deklaruar së sa i përket pretendimeve të të paditurit përmes të autorizuarit sa i përket thënieve nga i autorizuari i palës se paditur lidhur me kompensimin e dëmit lidhur me kompensimin e dëmit me punë nga i padituri e kundërshtojmë në tërësi për faktin së ne si palë paditëse jemi të obliguar që brenda një afatit ligjor ti kompensojmë dëmin të dëmtuarve të cilat dëme shkaktoi nga shakataret e aksidentit të cilët janë pa mbulesë siguruese e në këtë rast nuk kemi pranuar as një provë me të cilën i dëmtuari është kompensuar lidhur me dëmin e shkakuar nga i paditurit, andaj kjo marrëveshje për paditësen është i relevantë, për faktin

se deri në seancën e dt. 26.01.2021 nuk kemi qenë të njoftuar për një marrëveshje të tillë, ndërsa sa i përket propozimit për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i ndërtimtarisë lidhur me lartësinë e demetit në pronë të njëjtën e kundërshtojmë për faktin se një ekspertizë e tillë është kryer, nga inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë, andaj nëse do te nxirr edhe një ekspertizë do të krijoheshin shpenzimet të pa nevojshëm si dhe do të prolongohet procedura. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetem në tërësi pranë deklarimeve paraprake si në seancën e kaluar duke i propozuar gjykatës që ta obligoi e paditurin që ta rimbursojë demin e shkarkuar në shumën e cekur si në padi dhe atë me kamat ligjore nga dita e ngritjes se kësaj padie deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e taksës për padi në shumën prej 30 €uro.

I autorizuari i të paditurit me anë të përgjigjes në padi, gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në përgjigje në padi gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbes në tërësi pranë përgjigjes se dhënë me shkrim duke deklaruar me tutje se për aksidentin që ka ndodhur me dt. 25.03.2017, në ja kemi kompensuar demin këtij R. M., nuk e kundërshtoi aksidentin e di se ka ndodhur dhe si ka ndodhur aksidenti, në momentin e aksidentit tek kthesa ka ndodhur aksidenti kam qenë pak shpejt dhe në atë moment e kam humbur kontrollin dhe e kam goditur një objekt pronë e te dëmtuarit R. M., pra nuk e kundërshtoi padinë sa i përket aksidentit por e kundërshtoi shumën e cila është shumë e madhe jam i pa punë, jam i gjendjes se dobët ekonomike, në i'a kemi kompensuar këtë dëmtim R. , me punë ndore të cilën e ka bërë babai im dhe gjykatës si provë ia dorëzoi një kopje të procesverbalit ekzekutimin e masës se diversiteti për kompensim demi me nr. 9800/17- 0505, të dt. 20.09.2017, me tutej i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se e kundërshtojmë si të pa bazuar padinë e duke shtuar me tutje, pasi qe është bërë kompensimi i demit të shkaktuar, sipas marrëveshjes së procesverbalit për ekzekutimin e masës se diversitetit kompensimi i demit nr. 9800/17-0505, dt. 20.09.2017, ashtu që pala e paditur është marr vesh në tërën me palën e dëmtuar dhe e ka bërë sanimin e demit të shkaktuar në plotësi i cili sanim është pohuar edhe nga i dëmtuar edhe me nënshkrimin e tij personal. Gjykatës i ka propozuar që të nxirret prova me ekspertizë të ndërtimtarisë, pasi qe i njëjti edhe është rindërtua dhe pohuar nga pala e dëmtuar, ashtu që pala e paditur gjykatës i propozon që në rast nevoje në cilësi të dëshmitareve ti propozoi edhe dëshmitaret si janë, M. B. dhe A. K., nga fshati Komuna e Ndërsa në fjalë përfundimtare ka deklaruar e kundërshtoi në terës kërkesëpadinë e cila është e pa bazuar nga vet fakti se objekti i shqyrtimit te këtij kontestit demi i shkaktuar është kompensuar në terës sipas marrëveshjes se nënshkruar nga i padituri, i dëmtuari dhe zyrtari sprovës, shpenzimet e nuk i ka kërkuar - specifikuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Lista e transferove lëshuar nga BKS, ujdia jashtëgjyqësore e lidhur me dt. 15.08.2017, me nr. 666/17, në Prishtinë në mes Byrosë Kosovare të Sigurimeve - BKS të cilën e përfaqëson A. K. dhe palën e dëmtuar av. Sh. G., certifikata e pronësisë e datës 30.06.2017, për ngastrën P-70806008-0046-0, kontrata për punë dhe detyra specifike me nr. 701/17, dt. 07.06.2017, 19 foto të objektit të dëmtuar, ekspertiza e ndërtimtarisë e punuar nga eksperti, inxh., S. B., e punuar në procedurën administrative, nga BKS, raporti i policisë nr. DR-3004-147-17, dt. 25.03.2017, raporti i zgjeruar i policisë, konfirmimi i sigurimit TPL – 3902702, lëshuar validiteti – 10.11.2011-10.11.2012, procesverbalit për Ekzekutimin e masës se diverzitetit kompensim demi me nr. 9800/17-0505, datës 20.09.2017, Ministria e Drejtësisë – shërbimi sprovues i Kosovës, po ashtu gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe deklaratimet e te autorizuarit të autorizuarve të ndërgjyqësve të bëra gjatë shqyrtimit kryesor.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Fillimit në mesë ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, respektivisht shkaktari i aksidentit të ndodhur me datën, 25.03.2017, dhe rrjedha e aksidentit të përshkruar në raportin e policisë.

Nga leximi i procesverbalit për ekzekutimin e masës së diversiteti kompensim i dëmit, Nr. 9800/17-0505, i datës 20.09.2017, gjykata e ka vërtetuar rrethanën se shkaktarit të aksidentit këtu të paditurit i është shqiptuar masa e diversitetit.

Nga raporti fillestar i aksidentit, procesverbali mbi shqimin, (Raporti i zgjeruar), me numër DR-3004-147-17, te datës 25.03.2017, Gjykata ka konstatuar se me datën, 25.03.2017, kishte ndodhur një aksident, komunikacioni se deri të aksidentit kishte ardhur kur, drejtuesi i automjetit A , K. S., gjatë qarkullimit në rrugën e fshatit, kur ka arritur në kryqëzim të rrugës –, për shkak të shpejtësisë, kushteve të rrugës për pasojë dele jashtë rrugës në krahun e djathtë të drejtimit ku edhe përplasat për murin e shtëpisë se pronarit R. M., të cilit i shkaktonte dëm material, pra drejtuesi i automjetit me veprimet e ti te pa kujdesshme ka shkaktuar dëme materiale si në pronën private dhe automjetin e po ashtu ka lënduar veten dhe pasagjeret në veturë.

I padituri K. S. , ditën kritike datë, 25.03.2017, ka drejtuar veturën e tipit, me targa, pa mbulës të vlefshëm të sigurimit, respektivisht pa regjistrimi të vlefshëm.

Nga provat e administruara gjykata konstaton se këtu paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, Rr. "Lidhja e Pejës", p.n. me seli Prishtinë, është detyruar që të dëmtuarit R. M. si pasojë të dëmit material të pësuar në aksidentin e datës, 25.03.2017 aksident ky i shkaktuar me lëshimet e këtu të paditurit K. S. , në emër të kompensimit të dëmit material të ia paguaj shumën e tërësishme prej, 764.00 €, që vërtetohet në bazë të ujdisë jashtëgjyqësor për kompensimin e dëmit material, të datës, 15.08.2017.

Nga certifikata e pronësisë gjykata ka vërtetuar konstatuar faktin se me datën, 25.03.2017, është shkaktuar dëm në pronë, kjo është vërtetuara edhe me anë të ekspertizës së ndërtimtarisë, fotove të objektit të dëmtuar.

Nga dokumenti urdhër transferim lëshuar nga BKS në Bankën, gjykata konstaton se të dëmtuarit R. M., përmes të autorizuarit të tij avokatit Sh. G., në xhirollogarinë e të autorizuarit të tij, ju është paguar në tërësi dëmi material i shkaktuar sipas këtij, në shumën totale prej, 764,00 euro.

Gjykata pasi vërtetoi këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 par 4 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimet e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia, aprovoi në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar.

Paditësja është dashur ta kompensojë dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 25.03.2017, në bazë të dispozitës së nenit 25 për Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të

Auto - përgjegjësisë, në të cilat shprehimisht parashihet se palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për zhdëmtim drejt për drejt kompanisë së sigurimit, dhe nëse i dëmtuari parashtron kërkesën për zhdëmtim kompanisë së sigurimit, siguruesi si përgjigjeje në kërkesë të tillë nuk mund të bëjë kundërshtimet, që do të mund të bënte ndaj të siguruarit në bazë të ligjit, ndërsa sipas dispozitës nga neni 18 paragrafi 4 të te njëjti ligje, Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar shpenzimet dhe kumatën. Gjykata pasi që shqyrtoi të gjitha provat në shkresat e lëndës e duke u mbështetur në dispozitat e cekura me lartë, erdhi në përfundim se paditësja ka qenë e obliguar ta përmbush detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasojë e këtij aksidenti, dhe se të paditëses nuk i mungon baza ligjore për të kërkuar nga i paditura rimbursimin e dëmit nga shkaktari i aksidentit, për arsye se me dispozita ligjore nga neni 18 par 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto - përgjegjësisë, që parashohin se Kompania e Sigurimit e cila mbulon rastin e pa siguruar, mund të kërkojë rimbursimin e dëmit nga shkaktari i aksidentit i cili në momentin e aksidentit ka qenë i pa siguruar respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, për çka edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Ndërsa me dispozitën e nenit 321 të LPK- së, shprehimisht është përcaktuar se: “ Nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme. Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, e që gjatë shqyrtimit gjyqësor i padituri nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, sa i përket shkaktari të aksidenti dhe rrjedhës së tij.

Gjykata me rastin e vendosje ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurit të dhëna në përgjigje në padi, si dhe deklaratimet e të autorizuarit të tij Z. B., avokat nga, gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe kundërshtimet e dhëna në fjalën përfundimtare mbetem në tërësi pranë dhe të gjitha deklaratimeve të dhëna në seancat e kaluar, se i padituri i ka kompensuar dëmit, të dëmtuarit R. M., dhe atë duke u mbështetur në Procesverbalin për Ekzekutimin e Masës së Diversitetit Kompensim Dëmi, me nr. 9800/17-0505, i datës 20.09.2017, dhe se nuk ka as një përgjegjësi ndaj paditëses, duke i propozuar gjykatës që të nxirret prova me ekspertizë të ndërtimtarisë, të cilin propozim gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar për faktin se nuk ishte i argumentuar propozimi për nxjerrjen e kësaj provë, si dhe rrethanë se aksidenti ka ndodhur me datën: 25.03.2017, dhe gjendja faktike mund të ketë ndryshuar për faktin se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore. E duke ju referuar dispozitës së nenit 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit: 319 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqësve, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi, respektivisht gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurit të theksuar në përgjigje në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare por ish-in pa ndikim që gjykata të vendoste në këtë rast përkatësisht në këtë procedurë ndryshe sepse nuk kishte mbështetje në as një dispozite konkrete ligjore, mirëpo nëse i padituri i beson suksesit në procedurë ai mund të kërkojë realizimin e të drejtës së tij në ndonjë procedurë tjetër.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispoziten e nenit 170 dhe 382 të LMD-së, dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr. 265/2020 të datës 01.12.2020, për rimbursimin të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjesisë, gjykata ka marr datën e ushtrimit të padisë dt. 19.06.2019, e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e paditësit ne këtë procedurë. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës paditëse dhe atë: 20 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

Nga arsyet e cekura si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG, Departamenti i
Përgjithshëm, C.nr.319/18 i dt. 24.01.2020.**

**G j y q t a r i;
Migjen Kastrati**

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes se të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.